



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI

4872

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më 27.02.2025

**Lënda:** Përcjellje “Kritereve dhe Procedurave për Licensimin e Agjencive Funerale/ Shtëpi Funerale(Salla Pritje), Në Territorin e Bashkisë Shkodër”

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Referuar shkresës nr.29065 prot, datë 24.12.2024, Ju kemi përcjellë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E AGJENCIVE FUNERALE/ SHTEPI FUNERALE(SALLA PRITJE), NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”**


Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; neni 18, Këshilli Bashkiak ka realizuar dëgjuesen Publike me datë 28.01.2025, ora 13.00.

Bashkia Shkodër ju përcjell dokumentin final (bashkëlidhur)“Për Miratimin e Kritereve dhe Procedurave për Licensimin e Agjencive Funerale/ Shtëpi Funerale(Salla Pritje), në Territorin e Bashkisë Shkodër”

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt!

KRYETAR



Lidhja nr.1

**KUSHTET DHE KRITERET PER  
LICENSIMIN E AGJENCIVE TE SHERBIMIT  
FUNERAL DHE SHTEPIVE FUNERALE (  
SALLAT E PRITJES)**

## I.QËLLIMI

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shërbimit funeral në territorin e Bashkisë Shkodër.
2. Agjencitë dhe Shtëpitë funerale(sallat e pritjes), ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim dhe vetëm pasi të jenë të licensuara nga struktura përkatëse në Bashkinë Shkodër.
3. Agjencitë e shërbimit funeral, duhet të disponojnë kapacitetet e duhura, për kryerjen e procedurave ndihmëse të menaxhimit të shërbesës, para dhe pas varrimit, plotësimin e praktikës dokumentare, shitjen e artikujve të varrimit.
4. Shtëpite funerale(sallat e pritjes) janë ambiente që shërben si shtëpi pritjeje për kryerjen e ritualeve të lamtumirës apo riteve të tjera në nderim të personave të vdekur.

## II. PERKUFIZIME

**Agjenci të shërbimit funeral** që në veprimtarinë e tyre kryejnë vetëm procedurat ndihmëse të menaxhimit të shërbesës së para/pas varrimit në të cilat kryhet aktiviteti i plotësimit të formaliteteve, si edhe shitja e artikujve të varrimit;

**Shtëpi funerale / Salla pritje** është ambienti i padukshëm nga jashtë, i cili shërben si shtëpi pritjeje për kryerjen e ritualeve të lamtumirës dhe riteve të tjera në nderim të personave të vdekur;

**Godine banimi shumefamiljare** është një objekt që ka shumë banesa të cilat shpërndahen në katet që ka objekti. Porta e hyrjes dhe mbulesa janë hapësira të përbashkëta;

**Godine banimi individuale** është objekt me një oborr vetjak i cili mund të jete me një, dy ose tre kate i destinuar për një familje të vetme;

**Hapësirat publike** janë trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik;

**Kundërvajtje administrative:** është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, akteve të këshillit bashkiak, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat parashikohet dënim administrativ.

**Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative** parashikohen: a) me ligj; b) me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta.

## III. BAZA LIGJORE

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligji Nr.9220, datë 15.4.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, të ndryshuar;

VKM nr.408/2015 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; VKM nr.1096/2015 “Për miratimin e rregullave kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave Publike”;

#### IV. DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME :

1. Agjencia e Shërbimit Funeral dhe Shtëpia funerale (Salla e pritjes) nuk lejohet të ushtrojë aktivitetin e tyre në Qendrën Historike të Qytetit të Shkodrës që përfshin rrugët : Gjuhadol, Kol Idromeno, 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori si dhe përgjatë rrugës "Hamz Kazazi" në qytetin e Shkodrës.
2. Agjencia e Shërbimit Funeral dhe Shtëpia funerale (Sallat e Pritjes) nuk lejohen të ushtrojë aktivitetin e tyre në godina banimi shumëfamiljare dhe as në shtesat të këtyre godinave
3. Agjencia e shërbimit funeral dhe Shtëpia funerale (Sallat e pritjes) duhet të jenë larg , në një distancë minimale prej 50 Ml në vijë ajrore nga objektet arsimore.
4. Agjencia e Shërbimit Funeral dhe Shtëpia funerale (Sallat e pritjes) duhet të ushtrojë aktivitetin e tyre vetëm në ambiente të brendëshme dhe të padukshme/ jo të dukshme nga jashtë.
5. Makinat e autofuneralit e kanë të ndaluar të qëndrojnë/parkohen në hapësirat publike.
6. Aplikimi për licensimin Agjencive të Shërbimit Funeral dhe Shtëpive funerale (Sallat e Pritjes) kryhet me kërkesë të vete subjekteve pranë bashkisë Shkodër.

#### V. KUSHTET DHE KRITERET PËR LICENSIMIN E AGJENCIVE TË SHËRBIMIT FUNERAL

1. Agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotesojnë këtë dokumentacion:
  - a. është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin e veprimtarisë me objekt shërbesën funerale dhe ka statusin aktiv;
  - b. nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
  - c. nuk është dënuar për ndonjë vepër penale;
  - d. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
  - e. të ketë shlyer taksat dhe tarifat vendore;
  - f. të jenë të pajisur me leje sanitare për ambientet që disponon. (instituti i higjenes).
2. Agjencitë duhet të disponojnë një ambient të domosdoshëm për kryerjen e procedurave administrative dhe për ekspozimin objekteve/materialeve.
3. Objekti duhet të jenë në pronësi apo me kontratë qiraje në emër të subjektit që ushtron veprimtarinë.
4. Të disponojë minimumi një kapak frigoriferik sipas përcaktimeve dhe specifikimeve përkëse të strukturave shtetërore në fushën e shëndetësisë.
5. Agjencia duhet të disponojë të paktën një automjet për shërbimin funeral, i cili duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi me specifikën (shërbim funeral), në emër të subjektit dhe me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.
6. Pronësia e objektit të mos jetë me "funksion banim" nga ku të vërtetohet me kartelë pasurie (lëshuar brenda tre muajve të fundit) , ose vërtetim pronësie nga ku të jete i përcaktuar funksioni i përdorimit të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastres.
7. Duhet të ketë të paktën 2 punonjës të cilët figurojnë të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Duhet të disponojë nr.tel. i aksesueshëm 24 orë.

## V. KUSHTET DHE KRITERET PËR LICENSIMIN TË SHTEPIVE FUNERALE (SALLA PRITJE) TË SHËRBIMIT FUNERAL

1. Shtepitë Funerale (Salla Pritje) duhet të plotesojnë këtë dokumentacion:
  - a) Të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin e veprimtarisë me objekt shërbesën funerale dhe ka statusin aktiv;
  - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
  - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale;
  - d) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
  - e) të ketë shlyer taksat dhe tarifat vendore;
  - f) të jenë të pajisur me leje sanitare për ambientet që disponon. (instituti i higjenes).
2. Objekti ku ushtrojnë aktivitetin Shtepitë Funerale (Salla Pritje) duhet të disponojnë minimalisht 2 ambiente si dhe të disponoj 3 (tre) vend parkingu (për ato subjekte të cilët nuk disponojnë shesh funksional për parkimin e jo më pak se 3 (tre) makinave në shërbim të tyre. Objekti duhet të jetë në pronësi apo me kontratë qiraje në emer të subjektit që ushtron veprimtarinë.
3. Pronësia e objektit të mos jetë me “funksion banim” nga ku të vërtetohet me kartelë pasurie (lëshuar brenda tre muajve të fundit), ose vërtetim pronësie nga ku të jete i percaktuar funksioni i përdorimit të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
4. Duhet të ketë të paktën 1 punonjës të cilët figurojnë të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Duhet të disponojë nr.tel. i aksesueshëm 24 orë.

## VI. SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MENYRAT E CAKTIMIT TË TYRE

1. Sanksionet/Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, janë:
  - a. Paralajmërim me shkrim/Akt konstatimi.
  - b. Procesverbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.
  - c. pezullimin e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit sipas afatit të pezullimit.
  - d. Heqjen e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit.
2. Sanksioni “Paralajmërim me shkrim” është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit.
3. Në rast përsëritje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.
4. Në rast vijimi të kryerjes së kundërvajtjes/kundërvajtjeve duke mosrespektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi pas aplikimit të masës administrative me gjobë, ndaj subjektit vijojnë masat në rend hirarkik :
  - a. Pezullimin e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit sipas afatit të pezullimit.
  - b. Heqjen e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit.

## VII. DISPOZITA KALIMTARE

1. Të gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitetin e tyre të shërbimit funeral, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi duhet të përshtasin veprimtarinë e tyre në përputhje me këto rregulla dhe të licencohen nga Bashkia Shkodër.
2. Masa e sanksioneve administrative, mënyra e caktimit, forma e ekezekutimit të tyre do jetë sipas parashkimeve/përcaktimeve në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës Fiskale të Bashkisë Shkodër.
3. Për sa nuk është parashikuar në këtë dokument, strukturat konstatuese dhe zbatuese i referohen sipas rastit akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.